

**Vendim nr. 71, datë 12.11.2025**

**(V-71/25)**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Marsida Xhaferllari, Kryesuese, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, anëtarë, me sekretare Anjeza Puka, në datën 11.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 8 (N) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

**KËRKUESE: NAUREDA LLAGAMI**

**SUBJEKT I INTERESUAR:**

**MBLEDHJA E POSAÇME E GJYQTARËVE TË GJYKATËS SË LARTË**, përfaqësuar nga Miran Kopani, me autorizim.

**OBJEKTI:**

**Shfuqizimi i vendimit nr. 80-25-3411, datë 13.10.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimi i çështjes për rigjykim në këtë gjykatë me një trup tjetër gjykues; ose në mënyrë alternative, nëse Gjykata Kushtetuese vlerëson se ka juridiksion fillestar për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje:**

**Shfuqizimin e vendimit të Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 30.09.2025 për zgjedhjen e z. Asim Vokshi si anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Votimit për nxjerrjen e rezultatit të votimit. Kthimin e çështjes Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për të vendosur shpalljen e zgjedhjes së anëtares së Gjykatës Kushtetuese znj. Naureda Llagami.**

**Pezullimi i vendimit nr. 2, datë 30.09.2025 të Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe vendimit nr. 80-25-3411, datë 13.10.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.**

**BAZA LIGJORE:** Nenet 17, 42, 131, pika 1, shkronjat “e” dhe “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 49, pika 3, shkronja “e”, 50, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

## **GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Genti Ibrahim i, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, Naureda Llagami (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (*Mbledhja e Posaçme*), i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Në datën 11.12.2024 kryetari i Gjykatës së Lartë, në cilësinë e kryetarit të organit të emërtesës, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për zgjedhjen e anëtarit të ri të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), për shkak të mbarimit të mandatit të gjyqtarës Holta Zaçaj. Kërkuesja ka shprehur interesin e saj për të kandiduar për këtë funksion kushtetues.

2. Pas verifikimit të kriterëve të kandidatëve për gjyqtar të Gjykatës, të përcaktuara nga Ligji Organik i Gjykatës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (*KED*), me vendimin nr. 17, datë 17.06.2025, ka vendosur lejimin e kandidimit edhe të kërkueses. Në vijim, KED-ja, pas përfundimit të pikëzimit të kandidatëve, me vendimin nr. 28, datë 17.09.2025, e ka vlerësuar kërkuesen me 89.3 pikë, kurse me vendimin nr. 33, datë 17.09.2025 ka miratuar listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve. Sipas kësaj liste, i pari është renditur kandidati A.V. me 89.5 pikë, e dyta kërkuesja me 89.3 pikë dhe i treti kandidati F.B. me 77.83 pikë. Në datën 23.09.2025 KED-ja, bazuar në parashikimet e nenit 7/ç të Ligjit Organik të Gjykatës, i ka

paraqitur organit të emërtesës, Gjykatës së Lartë, raportin dhe listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve, si dhe dokumentacionin shoqërues.

3. Në datën 25.09.2025 kryetari i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1, ka vendosur thirrjen e Mbledhjes së Posaçme në datën 30.09.2025 për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës.

4. Në datën 30.09.2025 është zhvilluar procesi i votimit të Mbledhjes së Posaçme, në të cilin kanë marrë pjesë 15 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë. Në përfundim të procesit të votimit, pas numërimit të votave të anëtarëve të Mbledhjes së Posaçme, komisioni i votimit ka konstatuar se kërkuesja ka marrë 8 vota, kandidati A.V. ka marrë 6 vota dhe kandidati tjetër F.B. nuk ka marrë asnjë votë, ndërsa një fletë votimi është shpallur e pavlefshme, për shkak se kishte edhe një shenjë tjetër përveç shenjës në kutinë e caktuar për të shprehur vullnetin për kandidatin. Për rrjedhojë, në kuptim të parashikimeve të pikës 4 të nenit 7/ç të Ligjit Organik të Gjykatës, në situatën që asnjë kandidat nuk ka arritur shumicën e 3/5-ve të votave të gjyqtarëve të pranishëm (9 vota), me vendimin nr. 2, datë 30.09.2025, Mbledhja e Posaçme ka zgjedhur kandidatin A.V., i renditur i pari në listën e KED-së për anëtar të Gjykatës. Ky vendim i është njoftuar Gjykatës dhe Presidentit të Republikës, me qëllim organizimin e ceremonisë së betimit të kandidatit për fillimin e detyrës.

5. Në datën 01.10.2025 kërkuesja, me pretendimin se vota e shpallur e pavlefshme ishte një votë në favorin e saj, ka kërkuar nga Gjykata e Lartë vënien në dispozicion të praktikës dokumentare të Mbledhjes së Posaçme të datës 30.09.2025. Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 4785/1, datë 02.10.2025, i ka vënë në dispozicion kërkueses kopje të fletëve të votimit dhe procesverbaleve dhe në datën 13.10.2025 edhe regjistrimin audio të asaj mbledhjeje.

6. Në datën 03.10.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë me objekt *“Marrjen e masës së përkohshme të sigurimit të kërkesëpadisë dhe pezullimin e vendimit nr. 2, datë 30.09.2025 të Mbledhjes së Posaçme të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes”*. Më tej, në datën 10.10.2025 kërkuesja ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë edhe kërkesëpadi, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 2, datë 30.09.2025 të Mbledhjes së Posaçme dhe deklarimin e rezultatit të votimit për kandidaten Naureda Llagami me 9 vota në favor të saj, duke u shpallur fituese për vakancën e krijuar në Gjykatë.

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 80-25-3411, datë 13.10.2025, ka vendosur: *“Nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor dhe për pasojë mospranimin e shqyrtimit të kërkesës për masë sigurimi padie (për mungesë juridiksioni)”*. Sipas asaj gjykate, vendimi i Mbledhjes së Posaçme është akt me natyrë juridiko-kushtetuese

dhe jo juridiko-administrative, ndaj nuk mund të kundërshtohet ose të pezullohet në gjykatën administrative.

8. Në datën 14.10.2025 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 80-25-3411, datë 13.10.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues, ose në kërkim alternativ, nëse Gjykata vlerëson se ka juridiksion në zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje: shfuqizimin e vendimit nr. 2, datë 30.09.2025, të Mbledhjes së Posaçme të Gjykatës së Lartë dhe deklarimin e rezultatit të votimit për kandidaten Naureda Llagami me 9 vota në favor të saj duke e shpallur fituese për vakancën e krijuar në Gjykatë. Po kështu, ajo ka kërkuar nga Gjykata edhe pezullimin e vendimeve nr. 2, datë 30.09.2025 të Mbledhjes së Posaçme dhe nr. 80-25-3411, datë 13.10.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

9. Në datën 15.10.2025 subjekti i interesuar, Mbledhja e Posaçme, ka paraqitur kërkesë për përjashtimin nga shqyrtimi i çështjes të gjyqtarit H.Z., të cilit i kishte mbaruar mandati kushtetues dhe pritej të zëvendësohej nga anëtari i sapozgjedhur nga Gjykata e Lartë. Sipas Mbledhjes së Posaçme, gjyqtari në fjalë ndodhej në kushtet e parashikuara nga neni 36, pika 1, shkronja “ç”, i Ligjit Organik të Gjykatës, pasi ai ishte duke qëndruar në detyrë deri në zëvendësimin e tij nga gjyqtari pasues, pra gjendej në konflikt interesi, pasi dukej të kishte interes personal në vijimin e mandatit, për rrjedhojë në vonesën e emërimit të pasardhësit të tij.

10. Në datën 16.10.2025 edhe kërkuësja ka paraqitur në Gjykatë kërkesë për përjashtimin nga shqyrtimi i çështjes të gjyqtarëve I.T. dhe M.S., me arsyetimin se këta gjyqtarë nuk ofrojnë garancitë e nevojshme për paanshmërinë në gjykim, për shkak se në ushtrimin e funksionit të anëtarit të KED-së, në vlerësimin e kandidatëve, konkretisht të kërkuësës dhe kandidatit tjetër A.V., ata kanë shprehur preferencë, duke vlerësuar dhe renditur këtë të fundit me pikë më lart se kërkuësja. Kjo situatë, sipas kërkuësës, ka përcaktuar zgjedhjen e kandidatit A.V. si gjyqtar kushtetues, për sa kohë asnjë nga dy kandidatët nuk ka fituar 3/5-at e votave të Mbledhjes së Posaçme.

11. Në datën 16.10.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit në datën 20.10.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve<sup>1</sup>, si dhe shqyrtimin e çështjes me përparësi.

---

<sup>1</sup> Gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Ilir Toska dhe Marjana Semini votuan kundër kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

12. Po në datën 20.10.2025 Mbledhja e Gjyqtarëve mori në shqyrtim edhe kërkesat për përjashtimin e tre gjyqtarëve nga gjykimi. Në lidhje me kërkesën e subjektit të interesuar, Mbledhjes së Posaçme, me vendimin nr. 24, datë 20.10.2025, Mbledhja e Gjyqtarëve<sup>2</sup> vendosi pranimin e saj si të bazuar, me arsyetimin se në kuptim të nenit 42, pika 2, të Kushtetutës, si dhe në zbatim të neneve 37, pika 1 dhe 36, pika 1, shkronja “ç”, të Ligjit Organik të Gjykatës dhe të nenit 18, pika 1, shkronja “ç”, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, pjesëmarrja në gjykim e gjyqtarit H.Z., në dukje, mund të krijonte te palët dyshimin e arsyeshëm të njëanshmërisë në kushtet kur vazhdimi i qëndrimit në detyrë të këtij gjyqtari përcaktohej nga finalizimi ose jo i procedurave për emërimin e gjyqtarit pasardhës që ishte edhe çështja objekt gjykimi para Gjykatës<sup>3</sup>. Kurse në lidhje me kërkesën e kërkueses për përjashtimin e gjyqtarëve I.T. dhe M..S., Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimet nr. 25 dhe nr. 25/I, datë 20.10.2025, vendosi rrëzimin e saj si të pabazuar, me arsyetimin se: *së pari*, ankimi kushtetues i paraqitur nga kërkuësja lidhej me procedurat e ndjekura nga Mbledhja e Posaçme e Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës dhe jo me procedurat e ndjekura nga KED-ja për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve; *së dyti*, ndonëse gjyqtarët për të cilët kërkohej përjashtimi, në cilësinë e tyre si anëtarë të KED-së, kishin kryer vlerësimin dhe pikëzimin e të dy kandidatëve, Mbledhja e Gjyqtarëve vërejti se pikëzimi i anëtarëve për gjyqtar të Gjykatës bëhet sipas rregullave dhe procedurave të mirëpërcaktuara në rregulloren përkatëse të KED-së dhe se anëtarët e saj, në çdo rast, kanë detyrimin të justifikojnë pikëzimin e kandidatëve<sup>4</sup>. Po në këtë datë, Mbledhja e Gjyqtarëve mori në shqyrtim edhe kërkesën e kërkueses për pezullimin e vendimeve të Mbledhjes së Posaçme dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për të cilën vendosi rrëzimin e saj, me arsyetimin se nuk u provua ardhja e pasojave të drejtpërdrejta, të pakthyeshme ose të pariparueshme në të drejtat apo interesat e kërkueses<sup>5</sup>.

---

<sup>2</sup> Gjyqtarja Fiona Papajorgji votoi për shqyrtimin e kësaj kërkesë përpara shqyrtimit paraprak të themelit të çështjes.

<sup>3</sup> Gjyqtarët Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahimimi votuan për rrëzimin e kërkesës për përjashtim, pasi vlerësuan se arsyet e parashtruara nga Mbledhja e Posaçme për përjashtimin e gjyqtarit H.Z. nga shqyrtimi i çështjes nuk përbëjnë shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 36, pika 1, i Ligjit Organik të Gjykatës. Kjo sipas qëndrimit të shprehur në *footnote* në vendimin nr. 24, datë 20.10.2025, të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

Gjyqtarët Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahimimi, për më tepër, mbajtën qëndrimin se kryetari i Gjykatës së Lartë nuk legjitimohet formalisht në paraqitjen e kërkesave procedurale për llogari të Mbledhjes së Posaçme pa autorizimin e shprehur të kësaj të fundit. Kjo sipas qëndrimit të shprehur në *footnote* në vendimin nr. 24, datë 20.10.2025, të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

<sup>4</sup> Gjyqtarët Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahimimi votuan për pranimin e kërkesës së kërkueses për përjashtimin e gjyqtarëve nga shqyrtimi i çështjes, duke i vlerësuar pretendimet e saj brenda shkaqeve të parashikuara nga neni 36, pika 1, i Ligjit Organik të Gjykatës. Kjo sipas qëndrimit të shprehur në *footnote* në vendimet nr. 25 dhe 25/I, datë 20.10.2025, të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

<sup>5</sup> Gjyqtarët Sandër Beci, Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahimimi votuan për pranimin e kërkesës, pasi sipas tyre u provua ardhja e pasojave të drejtpërdrejta në të drejtat ose interesat e kërkueses, të tilla që janë të pakthyeshme apo të pariparueshme.

13. Pas njoftimit të palëve nga Gjykata për shqyrtimin e çështjes në seancë plenare dhe të drejtën për të paraqitur parashtrime me shkrim, në datën 03.11.2025 kërkesja ka paraqitur kërkesë për shtimin/ndryshimin e objektit të kërkesës së saj kushtetuese. Mbledhja e Gjyqtarëve, pasi mori në shqyrtim kërkesën, me vendimin e datës 06.11.2025, njëzëri, vendosi: *“Pranimin e kërkesës së kërkueses Naureda Llagami. Saktësimin e objektit të kërkesës nr. 8 (N) Regjistri Themeltar, datë 14.10.2025, si vijon: “Shfuqizimin e vendimit nr. 80-25-3411, datë 13.10.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në këtë gjykatë me një trup tjetër gjykues; ose në mënyrë alternative, nëse Gjykata Kushtetuese vlerëson se ka juridiksion fillestar për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje: Shfuqizimin e vendimit të Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 30.09.2025 për zgjedhjen e z. Asim Vokshi si anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Votimit për nxjerrjen e rezultatit të votimit. Kthimin e çështjes Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për të vendosur shpalljen e zgjedhjes së anëtares së Gjykatës Kushtetuese znj. Naureda Llagami. Shtimi i bazës ligjore të kërkesës nr. 8 (N) Regjistri Themeltar, datë 14.10.2025 edhe me nenin 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës.”.*

14. Po ashtu, kërkesja në datën 10.11.2025 ka paraqitur në Gjykatë edhe aktin “Kërkesë”, me objekt “Kontrolli kushtetues mbi verifikimin e rrethanave që ndalojnë zgjedhjen e z. A.V. gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese”, për të cilën Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 11.11.2025, vendosi pushimin e shqyrtimit të saj për shkak të nevojës për plotësim sipas kërkesave të ligjit dhe vijimin e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual të kërkueses sipas objektit të saktësuar nga ajo dhe të pranuar me vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve të datës 06.11.2025.

## II

### Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. **Kërkesja** ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt për shkak të vendimit gjyqësor objekt kërkesë. Në mënyrë të përmblendhur ajo ka pretenduar:

i) *Për juridiksionin e Gjykatës:*

15.1. Bazuar në vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës (*vendimi nr. 36/2021*), përmbajtja e shkronjës “e” të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës nga pikëpamja materiale përfshin në objektin e kontrollit kushtetues çështjet substanciale të zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë së funksionit, ashtu edhe ato procedurale

për verifikimin e zgjedhjes së funksionarëve publikë. Bazuar në këtë vendim Gjykata ka pranuar juridiksionin në këto çështje. Në rastin konkret, objekt i ankimit kushtetues është procedura e ndjekur për zgjedhjen e funksionarit publik, gjyqtarit të ri të zgjedhur nga Mbledhja e Posaçme dhe thelbi ka të bëjë vetëm me vlerësimin dhe numërimin e një vote, e cila është shpallur e pavlefshme. Kërkuesja nuk kundërshton vlerësimin e vullnetit të anëtarëve të Mbledhjes së Posaçme, por konstatimin e shkeljeve procedurale të kryera nga komisioni i votimit gjatë leximit dhe vlerësimit të votës së vetme të shpallur të pavlefshme.

15.2. Bazuar në parimin e shtetit të së drejtës, çdo akt i organeve të pushtetit publik, i nxjerrë jashtë diskrecionit të dhënë nga Kushtetuta ose ligji, i nënshtrohet kontrollit gjyqësor. Në këtë aspekt, edhe pse nuk është rasti konkret, do t'i nënshtrohej kontrollit kushtetues edhe vullneti i anëtarëve të Mbledhjes së Posaçme, nëse ky vullnet do të ishte shprehur jashtë ose në tejkallim të diskrecionit të dhënë nga Kushtetuta për të emëruar njërin prej kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga KED-ja. Çështja e verifikimit të zgjedhjes së funksionarëve të organeve të sistemit të drejtësisë, të parashikuara në Kushtetutë, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës, përbën një çështje të juridiksionit fillestar të Gjykatës. Kjo dallon nga rastet e tjera të parashikuara nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës.

15.3. Rregullorja e Mbledhjes së Posaçme për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës, e miratuar me vendimin nr. 1, datë 24.02.2022 (*Rregullorja e Mbledhjes së Posaçme*), në ndryshim nga ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 115/2016*), që parashikon të drejtën e ankimit kundër vendimit të Mbledhjes së Posaçme të gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, edhe në aspektin e konstatimit të shpalljes së votave të pavlefshme dhe të shpalljes së rezultatit, në Gjykatën Administrative të Apelit, nuk parashikon të drejtën e ankimit për këtë aspekt në ndonjë organ tjetër të pushtetit publik ose gjyqësor. Ndaj çështja e legjitimitetit të kërkueses duhet të shqyrtohet bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës.

*ii) Për legjitimitetin e kërkueses:*

15.4. Referuar vendimit nr. 36/2021 të Gjykatës kërkuesja legjitimohet, pasi ka identifikuar funksionarin publik, shkeljen kushtetuese që pretendohet se është

cenuar gjatë procesit të zgjedhjes së anëtarit të Gjykatës, si dhe aktin që ka materializuar këtë shkelje. Po ashtu, nga procesi i votimit kërkuesja ka pësuar një cenim personal dhe të drejtpërdrejtë nga akti që kundërshton, pasi është shkelur procesi i zgjedhjes së saj, si dhe e drejta për t'u zgjedhur anëtare e Gjykatës.

*iii) Për themelin e pretendimeve:*

- 15.5. Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë *cenon të drejtën e aksesit në gjykatë*, pasi i ka mohuar kërkueses të drejtën për të kundërshtuar në gjykatë procedurën administrative të kryer për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës, mbi të cilën është mbështetur vendimi i Mbledhjes së Posaçme, procedurë në të cilën ajo është subjekt i prekur drejtpërdrejt dhe që ka sjellë pasoja ndaj saj, si dhe për të marrë një përgjigje për pretendimet e saj për procesin. Nuk ka asnjë përcaktim ligjor që të ndalojë ankimimin gjyqësor ndaj vendimit të Mbledhjes së Posaçme, vendim i cili, në fakt, është administrativ dhe për të cilin kërkuesja gëzon të drejtën e ankimit në rrugë gjyqësore, duke ia nënshtruar atë juridiksionit administrativ për të marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e saj. Përjashtimi i kërkueses si një kandidat fitues për vendin e anëtarit të Gjykatës në mungesë të një shqyrtimi gjyqësor të pretendimeve të saj për procesin përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së dhe shtetit të së drejtës.
- 15.6. Edhe në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës, nuk ka asnjë dispozitë ligjore e cila të ndalojë paraqitjen e ankimit në Gjykatë të kërkueses, që është një e drejtë kushtetuese, për kundërshtimin e vendimit të Mbledhjes së Posaçme. Legjislacioni në fuqi nuk ka përcaktuar as ndonjë ankim të posaçëm në ndonjë shkallë të pushtetit gjyqësor për vendimin e Mbledhjes së Posaçme. Me interpretimin që i ka bërë ligjit gjykata e shkallës së parë, ka kufizuar të drejtën e kërkueses për t'u ankuar ndaj vendimit të Mbledhjes së Posaçme.
- 15.7. Vota e shpallur e pavlefshme nga komisioni nuk përfshihet në rastet e nenit 13 të Rregullores së Mbledhjes së Posaçme, për rrjedhojë është e vlefshme për sa kohë që fleta e votimit e ka të qartë zgjedhjen e bërë nga gjyqtari. Në këtë rast nuk qëndron argumenti i cenimit të fshehtësisë së votës, pasi edhe në rast se votohet me shenjën "+", ajo mund të konfigurohet në mënyrë të tillë që një detaj i vogël të zbulojë fshehtësinë e votimit. Nëse do të bëjmë paralelizëm me proceset e votimit për zgjedhjet parlamentare dhe vendore, në nenin 116 të Kodit Zgjedhor përcaktohet se zgjedhësi, pasi merr fletën e votimit, shënon në vendin e përcaktuar nga fleta e votimit për subjektin zgjedhor dhe/ose kandidatin e parapëlqyer të

subjektit zgjedhor shenjën “x” ose “+” ose një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e tij. Referuar akteve rregullatore të procesit zgjedhor që miratohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (manualet përkatëse për numërimin e votave nga komisionet), rezulton se ky i fundit rastin kur në fletën e votimit gjenden shenjat identike si në rastin e kërkueses e ka konsideruar si rast vote të vlefshme.

- 15.8. Është cenuar thelbi i kriterit procedural dhe universal të leximit dhe vlerësimit të votës (së vlefshme), që lidhet me qartësinë e shprehjes së vullnetit të votuesit. Në rastin konkret komisioni është bazuar vetëm në aspektin formal, duke anashkaluar qëllimin dhe efektin që synohet të arrihet përmes parashikimit formal, duke konsideruar gjatë leximit dhe vlerësimit të votës një shenjë të bërë nga vetë votuesi, vullneti i të cilit është shprehur në formën e duhur.
- 15.9. Pretendimi i subjektit të interesuar se nuk duhet të zbatohen rregullat e Kodit të Zgjedhor, por parashikimet e Ligjit Organik të Gjykatës dhe Rregullores së Mbledhjes së Posaçme nuk është i bazuar, pasi në këtë rast ndodhemi përpara faktit të konfliktit të normave me fuqi të ndryshme juridike, ku norma me fuqi më të lartë ka epërsi ndaj asaj me fuqi më të ulët. Normat për leximin dhe vlerësimin e votës së anëtarëve të Mbledhjes së Posaçme, të thirrur për të zgjedhur gjyqtarin kushtetues, nuk burojnë nga Ligji Organik i Gjykatës, por nga Rregullorja e Mbledhjes së Posaçme, e cila nuk ka vlerë të njëjtë juridike me Kodin Zgjedhor, që sipas nenit 81, pika 2, të Kushtetutës është ligji i miratuar me tre të pestat.
- 15.10. Ndryshe nga sa pretendon subjekti i interesuar, edhe në votimin që realizohet në organet e sistemit të drejtësisë sipas ligjit nr. 115/2016, qartësia e vullnetit të shprehur të votuesit nuk është vetëm për votimin sipas Kodit Zgjedhor, por edhe për votimin e organeve kushtetuese të sistemit të drejtësisë (nenet 17 dhe 44 të ligjit nr. 115/2016). Qartësia e votimit në fletën e votimit është kriteri bazë dhe themeltar i vlerësimit të fletës së votimit dhe përcaktimit të vlefshmërisë së saj. Pakujdesi në votim, përfshirë edhe në trupën e Gjykatës së Lartë, mund të ndodhin. Po ashtu, ndryshe nga sa pretendon subjekti i interesuar, nuk mund të vlerësohet aspekti formal i shkëputur nga qëllimi dhe efekti që synohet të arrihet nëpërmjet tij, sepse kjo do të çonte në humbjen e vet kriterit të vlerësimit të standardit dhe parimit që synohet të mbrohet. Vlerësimi i çdo aspekti formal duhet të bëhet në lidhje të drejtpërdrejtë me qëllimin dhe efektin që kërkohet të arrihet përmes parashikimit të tij. Në rastin konkret vullneti është shprehur në mënyrë të qartë, por edhe në formën e duhur dhe të kërkuar, nëpërmjet vendosjes në

pozicionin e saktë të shenjës përkatëse të parashikuar për të shprehur vullnetin. Në këtë kuptim, në këtë rast është keqzbatuar efekti i shenjës së bërë nga votuesi, i cili e ka shprehur vullnetin e tij në formën e kërkuar dhe qartësisht vetëm për një kandidat.

16. **Subjekti i interesuar, Mbledhja e Posaçme**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

*i) Për juridiksionin e Gjykatës:*

- 16.1. Vendimi i Mbledhjes së Posaçme nuk mund t'i nënshtrohet juridiksionit kushtetues, pasi është një akt kushtetues me natyrë institucionale, dhe jo një akt i thjeshtë administrativ, ndaj të cilit mund të bëhet ankim gjyqësor nga individët që marrin pjesë në garën për t'u zgjedhur anëtar të Gjykatës. Vendimi nuk mund të kundërshtohet në asnjë gjykatë, pasi shpreh një vullnet institucional me natyrë kushtetuese për të bërë funksional një organ kushtetues dhe nuk ka për qëllim të krijojë pasoja me natyrë individuale ose kolektive, sikundër akti administrativ. Procedura e zgjedhjes së gjyqtarit nga Gjykata e Lartë nuk mund të jetë objekt i kontrollit gjyqësor as nga gjykata administrative, as nga vetë kjo Gjykatë.
- 16.2. Nëse Gjykata do të pranonte kërkimin e kërkuases për ta shpallur atë fituese për vendin vakant për të cilin ka kandiduar, do të tejkalonte kompetencat e saj kushtetuese e ligjore, duke qenë se ajo nuk ka asnjë kompetencë në zgjedhjen e anëtarit të saj. Referuar nenit 125 të Kushtetutës për emërimin/zgjedhjen e anëtarit të saj, vendimi i Gjykatës nuk mund të zëvendësojë apo t'i vendoset tre akteve të vullnetit të organeve të emërtesës. Nuk ekziston një mjet gjyqësor për të kontestuar emërimin ose zgjedhjen e gjyqtarit kushtetues, pasi është vendim i politikëbërësit i mbështetur në vullnetin e organit kushtetues, të cilit i është lënë kompetenca për të zgjedhur/emëruar anëtarin e Gjykatës.
- 16.3. I vetmi rast ku Gjykata mund të kishte juridiksion për të shqyrtuar procesin e zgjedhjes së gjyqtarit të saj është rasti kur vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit (neni 127, pika 1, shkronja "d", i Kushtetutës dhe neni 9, pika 1, shkronja "d", i Ligjit Organik të Gjykatës). Për sa kohë ky pretendim nuk është ngritur nga kërkuësja, Gjykata nuk mund të shprehet kryesisht për të. Gjithsesi, edhe sikur të ishte kërkuar prej kërkuases, sërish ajo nuk do të legjitimohej, pasi nuk ka interes të ligjshëm. Pretendimi për pazgjedhshmërinë e gjyqtarit duhet të plotësojë kushtin që gjyqtari të ketë filluar

ushtrimin e detyrës, pra të jetë zgjedhur/emëruar dhe të ketë bërë betimin te Presidenti i Republikës.

ii) *Për legjitimimin e kërkueses:*

16.4. Kërkuësja nuk legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione materiae*, pasi nuk ka arritur të argumentojë se cila është e drejta që i është cenuar dhe sesi preket ajo personalisht nga vendimi i Mbledhjes së Posaçme. Ajo ka konkurruar për t'u zgjedhur anëtare e Gjykatës, por nuk ka një të drejtë subjektive që të zgjidhet, por vetëm pritshmëri për t'u zgjedhur. Kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë interesin e ligjshëm që i është cenuar përmes mohimit të aksesit, që është një e drejtë procedurale që duhet patjetër të lidhet me një të drejtë materiale që të mbrohet në gjykatë. Kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë as cenimin ose dëmin e shkaktuar nga vendimi i Mbledhjes së Posaçme, i cili nuk synon dhe nuk sjell pasoja për të, por për organin kushtetues që formësohet nga vullneti i atij organi.

16.5. Kërkuësja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohej Gjykatës. Ajo kundërshton një vendim të gjykatës së shkallës së parë, e cila e ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, pa iu drejtuar më parë me ankim të veçantë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, siç është disponuar në dispozitivin e vendimit objekt kundërshtimi dhe siç është parashikuar në nenin 9 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (ligji nr. 49/2012), si dhe nenin 59 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Argumenti i kërkueses bazohet vetëm në supozime dhe jo në ndonjë fakt juridik ose jurisprudencë të provuar.

iii) *Për themelin e pretendimeve:*

16.6. Pretendimi se në rastin e saj duhet të gjejnë zbatim rregullat e Kodit Zgjedhor është i pabazuar, pasi ato gjejnë zbatim vetëm në rast se nuk ka një ligj të posaçëm që parashikon rregulla të tjera që përjashtojnë ose zëvendësojnë dispozitat e tij. Në rastin e kërkueses, procesi i votimit nga Mbledhja e Posaçme është bazuar në Ligjin Organik të Gjykatës dhe Rregulloren e Mbledhjes së Posaçme, e miratuar në bazë të këtij ligji, ndaj nuk mund të zbatohen dispozitat e Kodit Zgjedhor.

16.7. Votimet politike ndryshojnë nga votimet institucionale që zhvillohen brenda organeve kushtetuese ose ligjore, pasi dy proceset kanë funksione, trupa gjykuese dhe qëllime të ndryshme, dhe legjislatori ka vendosur standarde të veçanta për secilin rast. Në proceset zgjedhore politike parimi themelor është qartësia e vullnetit të zgjedhësit. Në këtë rast fshehtësia e votës mbron qytetarin nga ndikimi

dhe presioni, por nuk e bën të pavlefshme një votë kur qëllimi është i qartë, edhe nëse shënimi nuk ndjek formën e saktë të përcaktuar. Ky standard përligjet nga vetë karakteri masiv dhe heterogjen i trupës votuese, e cila përfshin shtetas të niveleve të ndryshme arsimore dhe profesionale. Në votimet politike legjitimiteti buron nga vullneti i sovranit. Qëllimi është të garantohet që çdo zgjedhës, pavarësisht nivelit arsimor, të mund të shprehë lirisht zgjedhjen e tij. Në këtë proces qartësia e votës prevalon mbi formalizmin. Ndërsa në votimet institucionale legjitimiteti buron nga rregullsia procedurale, fshehtësia dhe paanshmëria. Të gjitha normat ligjore që rregullojnë këtë proces votimi janë të parashikuara nga ligji nr. 115/2016 (nenet 17, 45, 115, 143 etj.), ku janë vendosur rregulla të njëjta për pavlefshmërinë e votës, të cilat parashikojnë se çdo shenjë ose shkrim shtesë në fletën e votimit e bën atë të pavlefshme *ipso iure* dhe se në fletën e votimit nuk lejohet të bëhen shënime në favor ose disfavor të kandidatëve. Ky standard synon të sigurojë që vullneti i votuesit të shprehet në mënyrë të qartë, të pastër dhe të pidentifikueshme, duke përjashtuar çdo mundësi që përmes shenjave ose shkrimeve shtesë të cenohet fshehtësia e votës, të krijohen dyshime për autenticitetin e saj ose të lehtësohet identifikimi i votuesit. Përmes këtij rregulli ligjvënësi garanton integritetin e procesit të votimit, barazinë ndërmjet kandidatëve dhe besueshmërinë e vendimmarrjes së organeve të qeverisjes së drejtësisë. Në proceset e votimit që zhvillohen brenda institucioneve të drejtësisë, parimi themelor është fshehtësia dhe integriteti formal i votës. Këto votime nuk kanë karakter politik ose përfaqësues, por përbëjnë akte juridike të brendshme, të cilat prodhojnë pasoja direkte për strukturën dhe funksionimin e organeve kushtetuese. Trupa votuese në këto procese është e kufizuar numerikisht, e përbërë nga persona me kualifikim të lartë juridik, të cilët njohin rregullat procedurale dhe formale të fshehtësisë së votës, njohin dhe kuptojnë plotësisht formën e fletës së votimit dhe efektet e çdo devijimi prej saj.

- 16.8. Fleta e votimit është e pavlefshme, pasi nuk respekton përcaktimet e neneve 12, pika 6 dhe 13, shkronja “b”, të Rregullores së Mbledhjes së Posaçme, të cilat synojnë fshehtësinë dhe uniformitetin e votës. Ndalimi i shënimeve shtesë të parashikuara në këto dispozita është vendosur për të shmangur çdo lloj identifikimi të votës. Parashikimet e këtyre dispozitave janë rregulla të ndalimit absolut. Për të shpallur votën të pavlefshme nuk mjafton vetëm nëse vullneti është shprehur qartë apo jo. Votimi nuk është vetëm një akt i shprehjes së vullnetit, por

dhe akt që duhet të mbetet i fshehtë. Edhe pse vullneti i votuesit mund të lexohet qartësisht në favor të një kandidati, vota mbetet e pavlefshme, sepse shkel parimin e fshehtësisë dhe të uniformitetit të procesit. Në procesin e votimit për anëtar të Gjykatës, qartësia e vullnetit nuk mjafton, por ajo duhet të shprehet në formën e qartë juridike, përndryshe cenon integritetin e procesit. Për më tepër që në rastin konkret votues janë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, që e njohin mjaft mirë ligjin.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për juridiksionin e Gjykatës

17. Gjykata, referuar objektit të kërkesës në shqyrtim, vëren se kërkesja ka ngritur dy kërkitime: *i pari*, lidhet me konstatimin si antikushtetues të vendimit nr. 80-25-3411, datë 13.10.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që ka disponuar për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor dhe për pasojë mospranimin e shqyrtimit të kërkesës së saj për sigurimin e kërkesëpadisë, si dhe pezullimin e vendimit nr. 2, datë 30.09.2025 të Mbledhjes së Posaçme; *i dyti*, ka të bëjë me zgjedhshmërinë/procesin zgjedhor për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës nga Mbledhja e Posaçme, të zhvilluar në datën 30.09.2025, për rrjedhojë konstatimin antikushtetues të zgjedhjes së anëtarit të Gjykatës nga Mbledhja e Posaçme dhe shfuqizimin e vendimit të saj, si dhe kthimin e çështjes Mbledhjes së Posaçme për të vendosur shpalljen e zgjedhjes së kërkueses si anëtare të Gjykatës. Gjykata, bazuar në objektin e kërkesës, por edhe në thelbin e pretendimeve, vlerëson se kërkitimi i parë për kushtetutshmërinë e vendimit gjyqësor që ka disponuar për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, *prima facie* duket se përfshihet në fushën e veprimit të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, kurse kërkitimi i dytë, ai për kushtetutshmërinë e zgjedhshmërisë/procesit zgjedhor për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës nga Mbledhja e Posaçme, të zhvilluar në datën 30.09.2025, përfshihet në shkronjën “e” të po kësaj dispozite.

18. Për sa i takon referimit të kërkueses në shkronjën “f” të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës, Gjykata konstaton se, në kuptim të kësaj dispozite, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund ta vërë atë në lëvizje për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Gjykata vëren se në rastin konkret kërkesja ka kundërshtuar procesin gjyqësor, ku ka qenë palë në cilësinë e paditëses, në kuadër të të cilit është nxjerrë vendimi i gjykatës administrative të shkallës së parë dhe nga i cili është bartëse e të drejtave kushtetuese që lidhen me atë proces. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se ky

vendim gjyqësor mund të kundërshtohet në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ndaj kjo dispozitë mund të shërbejë si bazë kushtetuese për kërkimet e parashtruara nga kërkuesja.

19. Kërkuesja ka kundërshtuar në objektin e kërkesës si procesin gjyqësor në gjykatën administrative të shkallës së parë, ashtu edhe vetë procedurën e votimit të zhvilluar nga Mbledhja e Posaçme dhe rezultatin e atij procesi, duke kërkuar edhe deklarimin e votës së dhënë në favorin e saj të vlefshme. Sipas kërkueses, bazuar në vendimin nr. 36/2021 të Gjykatës, përmbajtja e shkronjës “e” të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës nga pikëpamja materiale përfshin në objektin e kontrollit kushtetues çështjet substanciale të zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë së funksionit dhe ato procedurale për verifikimin e zgjedhjes së funksionarëve publikë. Po ashtu, kërkuesja ka parashtruar se vetë Gjykata, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës, me vendimin nr. 36/2021 të saj ka pranuar juridiksionin e plotë për të vendosur për këtë çështje.

20. Sipas subjektit të interesuar, Mbledhjes së Posaçme, vendimi i saj nuk mund t’i nënshtrohet juridiksionit kushtetues, pasi është një akt kushtetues me natyrë institucionale dhe jo një akt i thjeshtë administrativ, ndaj të cilit mund të bëhet ankim gjyqësor nga individët që marrin pjesë në garën për t’u zgjedhur anëtar i Gjykatës. Sipas këtij subjekti, vendimi i Mbledhjes së Posaçme nuk mund të kundërshtohet në asnjë gjykatë, pasi shpreh një vullnet institucional me natyrë kushtetuese për të bërë funksional një organ kushtetues dhe nuk ka për qëllim të krijojë pasoja me natyrë individuale ose kolektive, sikundër akti administrativ dhe procedura e zgjedhjes së anëtarit të Gjykatës nga Gjykata e Lartë nuk mund të jetë objekt i kontrollit gjyqësor as nga gjykata administrative, as nga vetë Gjykata. Nëse Gjykata do të pranonte kërkimin e kërkueses për ta shpallur atë fituese për vendin vakant pranë saj, do të tejkalonte kompetencat e saj kushtetuese e ligjore, duke qenë se ajo, sipas Kushtetutës dhe ligjit, nuk ka asnjë kompetencë në zgjedhjen e anëtarit të saj. Po sipas këtij subjekti, Gjykata nuk mund të zëvendësojë ose t’i vendoset tre akteve të vullnetit të organeve të emërtesës, kur vjen çështja tek emërimi/zgjedhja e anëtarëve të saj.

21. Përkundrejt pretendimeve dhe prapësimeve të palëve si më sipër, lidhur me kërkimin e kërkueses në këndvështrim të nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata vendos për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve dhe funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre, ajo çmon të ndalet në vlerësimin e juridiksionit të saj në këtë drejtim.

22. Gjykata vëren se neni 131, pika 1, shkronja “e”, i Kushtetutës parashikon se ajo vendos për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit, deputetëve dhe funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre. Përmbajtja e shkronjës “e” të pikës 1 të nenit 131 të Kushtetutës nga pikëpamja materiale përfshin në objektin e kontrollit kushtetues çështjet substanciale të zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë së funksionit dhe ato procedurale për verifikimin e zgjedhjes së këtyre funksionarëve publikë (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me institutet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë, Gjykata ka theksuar se pazgjedhshmëria synon të ndalojë një kandidat të caktuar që të mund të emërohet në një funksion publik ose të fitojë një mandat nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në zgjedhje, kurse papajtueshmëria ka të bëjë me ndërprerjen e funksionit ose mandatit në rast se verifikohen shkaqe që nuk lejojnë ushtrimin e lirë dhe të pandikuar të tij. Në çdo rast, si shkak pazgjedhshmërie ose papajtueshmërie shërbejnë fakte, rrethana ose sjellje që ndalojnë emërimin ose zgjedhjen, ose bëjnë të pamundur ushtrimin e funksionit publik, të cilat mund të jenë të parashikuara nga norma kushtetuese ose në ligje të veçanta. Instituti i papajtueshmërisë mbron ushtrimin e mandatit ose funksionit dhe synon parandalimin e mbivendosjes së kompetencave të ndara tek i njëjti person ose organ, në këtë mënyrë moscenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si element i shtetit të së drejtës (*shih vendimet nr. 36, datë 04.11.2021; nr. 7, datë 24.02.2016; nr. 44, datë 07.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata, duke iu referuar jurisprudencës së lartpërmendur, ka vlerësuar se kontrolli kushtetues për këto çështje ka natyrë individuale, pasi bazohet në vlerësimin e shkeljes konkrete për ato ndalime kushtetuese ose ligjore që përbëjnë shkak për konstatimin e papajtueshmërisë ose pazgjedhshmërisë në ushtrimin e funksionit publik. Në çështjet e përfshira në rregullimin e shkronjës “e” të pikës 1 të nenit 131, jo vetëm që bëhet fjalë për individin që merr funksion zyrtar, por qëllimi i saj është mbrojtja e interesit publik që në organe të parashikuara nga Kushtetuta funksionarët të zgjidhen sipas procedurave kushtetuese përkatëse dhe që plotësojnë kriteret e zgjedhshmërisë dhe pajtueshmërisë me funksionin (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Me qëllim ushtrimin e kësaj kompetence nga Gjykata, kërkesa për verifikimin e zgjedhjes duhet të identifikojë funksionarin publik, shkeljen kushtetuese që pretendohet se është kryer gjatë procesit të zgjedhjes së tij, si dhe aktin konkret që materializon shkeljen kushtetuese. Për pasojë, procedura e verifikimit të zgjedhjes së funksionarëve të organeve të parashikuara nga Kushtetuta duhet parë e lidhur me këto koncepte dhe jo e lidhur me vlerësimin, qoftë edhe në aspektin e kushtetutshmërisë të

procesit zgjedhor në tërësinë e tij (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Togfjalëshi “verifikimin e zgjedhjes së tyre” në përmbajtjen e nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës duhet të interpretohet në kuptimin që ai ka të bëjë me verifikimin e respektimit të së drejtës individuale për t`u zgjedhur të funksionarit të organit kushtetues gjatë procesit zgjedhor (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vëren se kërkuesja ka identifikuar funksionarin publik të zgjedhur, që është anëtari i ri i Gjykatës i zgjedhur me vendimin nr. 2, datë 30.09.2025 të Mbledhjes së Posaçme, si dhe ka ngritur pretendime për kontrollin kushtetues të aspekteve procedurale të zgjedhjes së këtij funksionari publik. Po ashtu, Gjykata konstaton se kërkuesja ka pretenduar se në rastin konkret janë të pranishme ato rrethana që nuk lejonin zgjedhjen e anëtarit të ri të Gjykatës, për sa kohë që nuk ishte rasti sipas nenit 7/ç, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës që ai të konsiderohej i zgjedhur për shkak të ligjit, si kandidati i renditur i pari, për sa kohë që votat e marra nga kërkuesja përbënin kuorumin e nevojshëm ligjor sipas së njëjtës dispozitë (9 vota). Për rrjedhojë, në rastin konkret kërkuesja ka kërkuar nga Gjykata të ndalet në “verifikimin e zgjedhjes” së funksionarit në drejtim të shkeljes konkrete që ka të bëjë me (mos)ekzistencën e ndalimeve ligjore që do të përbënin shkak për konstatimin e pazgjedhshmërisë së funksionarit publik, duke kundërshtuar edhe aktin konkret që materializon shkeljen kushtetuese të pretenduar, që është vendimi i Mbledhjes së Posaçme. Gjykata mban në konsideratë gjithashtu se në rastin e kërkueses (pa)rregullshmëria e procesit nuk i është nënshtruar asnjë kontrolli, për sa kohë që komisioni i votimit është organi i vetëm që ka bërë një interpretim si të rregullave të zbatueshme ashtu edhe të vullnetit të zgjedhësit, në mungesë të një vlerësimi tjetër të anëtarëve të Mbledhjes së Posaçme (gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë) lidhur me interpretimin e këtyre rregullave dhe procedurës në tërësinë e saj.

25. Për rrjedhojë, kërkimi për konstatimin antikushtetues të procesit zgjedhor të zhvilluar në datën 30.09.2025 për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës nga Mbledhja e Posaçme dhe shfuqizimin e vendimit të kësaj të fundit, bën pjesë në juridiksionin kushtetues, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës.

26. Për sa më sipër, duke qenë se Gjykata arriti në përfundimin se pretendimet e ngritura nga kërkuesja në ankimin kushtetues individual sipas nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës, të cilat në thelb lidhen me procesin zgjedhor për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës nga Mbledhja e Posaçme, bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, vlerëson të mos marrë në analizë veçmas pretendimet e kërkueses për antikushtetutshmërinë e vendimit gjyqësor nr. 80-25-3411, datë 13.10.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, por t`i shohë ato të lidhura me analizën e saj për

legjitimimin e kërkuases për kërkimin për shfuqizimin e vendimit nr. 2, datë 30.09.2025 të Mbledhjes së Posaçme dhe të vendimit të komisionit të votimit për nxjerrjen e rezultatit të votimit.

#### *B. Për legjitimimin e kërkuases*

27. Për kërkimin sipas nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës, kërkuësja ka pretenduar se nga procesi i votimit ajo ka pësuar një cenim personal dhe të drejtpërdrejtë nga akti që kundërshton, pasi i është shkelur procesi i zgjedhjes së saj, si dhe e drejta për t’u zgjedhur anëtare e Gjykatës.

28. Sipas subjektit të interesuar, Mbledhjes së Posaçme, lidhur me kërkimin sipas nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës, kërkuësja nuk legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione materiae* për të vënë në lëvizje Gjykatën, pasi nuk ka arritur të argumentojë se cila është e drejta që i është cenuar dhe si preket personalisht nga vendimi nr. 2, datë 30.09.2025.

29. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

30. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të parë të legjitimitetit *ratione personae*, Gjykata, në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

31. Kështu, sipas njërit qëndrim, nga analiza e parashikimeve kushtetuese dhe Ligjit Organik të Gjykatës, kërkuësja, në cilësinë e individit, nuk legjitimohet *ratione personae* t’i drejtohet Gjykatës për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë e funksionarit të organeve të parashikuara në Kushtetutë sipas nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës. Kërkuësja si individ mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues për çdo akt të pushtetit publik, siç janë edhe vendimet që ajo kundërshton, me ankim kushtetues individual sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Mirëpo kjo dispozitë për legjitimimin e individit kërkon që akti i

pushtetit publik t'i ketë cenuar atij të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga Kushtetuta. Në këtë pikëpamje, sipas këtij qëndrimi, e drejta për t'u zgjedhur në funksionin e gjyqtarit të Gjykatës nuk përbën të drejtë themelore kushtetuese, ndaj kërkesja nuk legjitimohet *ratione personae*<sup>6</sup>.

32. Sipas qëndrimit tjetër, individët që garojnë për funksionet e parashikuara në Kushtetutë legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës për kushtetutshmërinë e procesit të zgjedhjes për sa kohë janë pjesë e atij procesi. Për pasojë, ata justifikojnë interesin e tyre për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë sipas nenit 131, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës, bazuar edhe në nenin 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës<sup>7</sup>.

33. Për sa më lart, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh në lidhje me kriterin e legjitimitimit *ratione personae*, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa e kërkueses konsiderohet e rrëzuar, ndaj nuk është e nevojshme as analiza e mëtejshme e plotësimit të kriterëve të tjera për legjitimitimin.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronjat “e” dhe “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72, 73, pika 4 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 12.11.2025**

**Shpallur më 30.12.2025**

---

<sup>6</sup> Votuan për moslegjitimitimin *ratione personae* gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Ilir Toska dhe Marjana Semini.

<sup>7</sup> Votuan për legjitimitimin *ratione personae* gjyqtarët Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahimimi.